



Prishtinë, 29.01.2024
Kodi i ZRRE-së: V_1865_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2474_12_23** i dt.06.12.2023;
- Kundërshtimi i konsumatorit i datës **04.01.2024**.

në seancën e mbajtur më datë 29.01.2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i konsumatorit N.L ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2474_12_23 i dt.06.12.2023.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 06.12.2023 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2474_12_23 me të cilin ZRrE është shpallur jokompetente për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës së konsumatorit N.L, lidhur me borxhin e papaguar ndaj KEK, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KEK SH.A – Departamenti Juridik të datës 22.12.2022 lidhur me kërkesën për shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike nga transaksionet e konsumatorit.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori N.L, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se ZRRE nuk ka marr per bazë kërkesën per shlyerjen e borxhit per shkak te vjetërsisë;
- Pala kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të anulojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2474_12_23 i datës 06.12.2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e konsumatorit se vendimin nr. ZRRE/DMK_V_2474_12_23 i datës 06.12.2023 i Departamentit për Mbrojtjen e konsumatorëve nuk është i drejt, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha



provave dhe shkresave si: Ankesa e konsumatorit në KEK – SH.A datë 15.12.2022; Përgjigja e KEK-ut e datës 22.12.2022; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 06.03.2023; Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_ V_2474_12_23 i datës 06.12.2023, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike, listat e leximi, ka gjetur se nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

ZRrE ka vërejtur se, Me datë 15.12.2022 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin Juridik në KEK– SH.A duke kundërshtuar borxhin e mbetur ne transaksionet e konsumatorit me njehsorin elektrik nr. **62194637**. Me datë 02.06.2023 Departamenti Juridik ne KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit. Departamenti Juridik në KEK ne përgjigjen ne ankesë te konsumatorit thekson se sipas ligjit nuk ka të drejtë të ja falë borxhin askujt. Gjithashtu KEK ne përgjigjen e tyre thekson se lidhur me kërkesën e palës per parashkrim te borxhit, tashmë ka kaluar koha kur është dashur të bëni kërkesë per faljen e borxhit.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar transaksionet e konsumatorit me te cilat vërtetohet se konsumatori nuk ka bere kërkesë per falje te borxhit ashtu siç edhe parashihet me LIGJI Nr. 05/L -043 për Faljen e Borxheve Publike te miratuar ne Kuvendin e Republikës se Kosovës. Bazuar ne ligjin e lartë përmendur përkatësisht nenin 4 paragrafin 1 thuhet se: Nga falja e borxheve publike për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, sipas këtij ligji përfitojnë të gjithë personat të cilët kanë obligime të pashlyera ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike, me kusht që të njëjtit:

- 1.1 Të kryejnë pagesën e plotë të obligimeve për periudhën nga 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014, atëherë personat e këtillë, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe me faljen e gjobave, ndëshkimeve, interesit dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e kryegjësë së borxhit për periudhën 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014, ose;
- 1.2 Të lidhin marrëveshje me Institucionin Shtetëror apo Ndërmarrjen Publike për pagesën e borxheve me këste për periudhën 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014. Në rastin kur arrihet marrëveshja sipas nën-paragrafit 1.2 të këtij neni, atëherë personat e këtillë, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe faljen e ndëshkimeve për periudhën 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014. Pagesa e borxhit sipas këtij paragrafi duhet te kryhet:

1.2.2. Brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga personat fizikë, nga data e lidhjes së marrëveshjes

ZRRE ka shqyrtuar te gjitha shkresat e dërguara nga konsumatori por informon te njëjtin se nuk ka kompetence ligjore te bëjë shqyrtimin e ankesës suaj lidhur me faljen e borxheve duke pasur parasysh se nuk është vërejtur asnjë vërejtje nga i licencuari per kërkesën e parashtruar dhe se nuk është aplikuar me kohe ne përputhje me ligjin per falje te borxheve. ZRRE po ashtu informon konsumatorin se bazuar ne te drejtat ligjore qe i takojnë mund te aplikojë ne Ministrin per Pune dhe Mirëqenie Sociale me qellim te përfitimit te mbrojtjes sociale e ku përfshihet edhe subvencionimi i faturave te energjisë elektrike.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori N.L në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrik, transaksionet e konsumatorit, faturat e konsumatorit, LIGJIN Nr. 05/L -043 për Faljen e Borxheve Publike si dhe nenit 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet ne gjuhet zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, kryesues

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Arta Qorolli, anëtare

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **N.L** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.